



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"**

Ref. nr. 379/23

Pejë

RREGULLORE PËR UNIVERSITETIN VEROR NDËRKOMBËTAR UNISUM

**Pejë,
20.02.2023**

Në bazë të nenit 42, 47, 48, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ-së në mbledhjen e mbajtur më dt. 20.02.2023, miratoj këtë:

RREGULLORE PËR UNIVERSITETIN NDËRKOMBËTAR VEROR - UNISUM

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj misionin, vizionin, strukturën menaxhuese, organizimin, fushë veprimtarinë, funksionet, përgjegjësitë, kompetencat, procedurën disiplinore - etike dhe detyrat e Universitetit Ndërkombëtar Veror (më tutje "UNISUM") .
2. Qëllimi i UNISUM është i fokusuar drejtë studentëve të UHZ –së të motivuar e të orientuar ndërkombëtarisht për pjesëmarrje në shkëmbime akademike dy-javore së bashku me studentët të tjerë të interesuar nga e gjithë Evropa për të studiuar në mënyrë disiplinat mbi bazat e të cilave ata dëshirojnë të thelojnë të kuptuarit e tyre për çështjet aktuale evropiane dhe ndërkombëtare duke studiuar dhe diskutuar zhvillimet dhe sfidat globale në kontekstin e proceseve të transformimit dhe ndryshimeve ekonomike, juridike, artistike, agro –mjedisore që pasqyrojnë aspekte të identitete individuale, sociale, politike, kulturore, rajonale, kombëtare dhe evropiane.
3. Përveç komponentës akademike, në kuadër të këtij projekti studentëve pjesëmarrës u krijohen kushte dhe mundësi reale për të njohur kultura të tjera dhe t'u të miqësuar me studentë nga e gjithë Evropa.
4. Qëllimi i UNISUM karakterizohet për krijimi e një diversitet gjithnjë në rritje ne partneritet me institucione të njëjta apo të ngjashme akademike ndërkombëtare.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha strukturat menaxhuese të UNISUM, personelin akademik dhe studentët e UNISUM.

Neni 3

Misioni

Programet e UNISUM transferojnë dije, shkathtësi dhe mësim cilësor për studentët vendor dhe ndërkombëtarë nëpërmjet kurseve nga fusha e biznesit, turizmit, agrobiznesit, juridikut dhe arteve dhe zgjerojnë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në një mjedis arsimor nëpërmjet një mjedisi të këndshëm e shoqëror dhe dëfryes.

Neni 4

Vizioni

UNISUM synon të jetë lider në ofrimin e programeve të studimit veror sfidues, tërheqëse, të kërkuara dhe të hapura për studentët vendor dhe ndërkombëtarë të cilët janë të motivuar për mësim aktiv nëpërmjet rritjes së mobilitetit akademik dhe shkencor.

Neni 5

Struktura menaxhuese e "UNISUM"

1. Struktura menaxhuese e "UNISUM" përbëhet nga:
 - 1.1. Këshilli Drejtues;
 - 1.2. Këshilli Organizativ;
 - 1.3. Koordinator i "Universitetit Ndërkombëtar Veror".

Neni 6

Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues i UNISUM është organi më i lartë i cili merret më përcaktimin e fushave, kushtet dhe kriteret si dhe procedurën e rekrutimit të stafit dhe studentëve.
2. Këshilli Drejtues i UNISUM përbëhet nga:
 - 2.1. Prorektori për bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë - Kryesues
 - 2.2. Prorektori mësimdhënies, çështjes së studentëve dhe kërkimeve shkencore;
 - 2.3. Prodekanët për mësimdhënie dhe çështje akademike;
 - 2.4. Drejtori për mësimdhënie dhe çështje akademike;
 - 2.5. Drejtori për bashkëpunim ndërkombëtar;
 - 2.6. Kryetari i parlamentit studentor;

Neni 7

Këshilli organizativ

1. Këshilli organizativ është organ që merret më organizimin e aktiviteteve brenda "UNISUM" dhe çështjet organizative të UNISUMIT të përcaktuara në këtë Rregullore;
2. Këshilli organizativ përbëhet nga:
 - 2.1. Koordinator i UNISUM – kryesues;
 - 2.2. Drejtori për Çështje të Studentëve
 - 2.3. Nga një zyrtar për çështje të studenteve të secilës njësi akademike (përcaktohet nga Sekretari i njësisë);
 - 2.4. Drejtori i IT – së;
 - 2.5. Një Studentë të propozuar nga Parlamenti Studentor
3. Këshilli organizativ e përgatit udhëzuesin për studentë si dhe dokumentet tjera relevante për funksionimin dhe mbarëvajtjen e "UNISUM".

Neni 8

Koordinatori i "UNISUM"

1. Koordinator i "UNISUM" ex-officio është Drejtori i Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar;
2. Koordinator është përgjegjësi kryesor administrativ për mbarëvajtjen e punës së "UNISUM".

3. Koordinatorin në koordinim më këshillin drejtues të UNISUM është përgjegjës për përcaktimin e orarit të organizimit të kurseve gjegjësisht moduleve;
4. Koordinatorin i "UNISUM" për punën e tij i përgjigjet Këshillit Drejtues të UNISUM dhe Senatit të UHZ –së.

Neni 9

Organizimi i punës dhe modulet e "UNISUM"

1. "UNISUM" ofron shkollim në formë modulare apo ligjëratave me karakter intensiv në kohëzgjatje deri në dy (2) javë.
2. Modulet propozohen organizohen nga njësitë akademike të UHZ –së , si në vijim:
 - a) Fakulteti i Biznesit;
 - b) Fakulteti i Menaxhmentit të Turizmit, Hotelarisë dhe Mjedisit;
 - c) Fakulteti i Agrobiznesit;
 - d) Fakulteti i Juridik; dhe
 - e) Fakulteti i Arteve.
3. Fushat e propozuara nga Këshilli Drejtues i UNISUMI aprovohen nga Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në rast nevojë (programe të përbashkëta) edhe në bashkëpunim me institucionet partnere dhe palët tjera të interesit.
4. Ligjëratat në module do të mbahen nga personeli akademik i UHZ dhe personeli i institucioneve partnere.
5. Modulet e "UNISUM" duhet të përgatiten paraprakisht dhe të njoftohen palët e interesuara.

Neni 10

Konkursi i "UNISUM"/thirrja e hapur

1. Konkursin dhe njoftimin për fillimin e punës dhe aktivitetëve të "UNISUM" çdo vit e përcakton dhe e shpall Këshilli Drejtues i UNISUM.
2. Afati i hapjes dhe mbylljes së konkursit përcaktohet nga Këshilli Drejtues i UNISUM;

Neni 11

Personeli akademik dhe organizimi i kurseve në "UNISUM"

1. Në Universitetin veror UNISUM, në parim kurset e ofruara organizohen nga dy mësimdhënës, prej të cilëve njëri është vendor dhe tjetri nga vendet e jashtme.
2. UHZ obligohet të shpall thirrje të hapur për pranimit të kurseve që përkojnë me fushat e studimit të UHZ duke marrë parasysh personelin akademik që i plotëson kushtet minimale akademike për ligjërimit në "UNISUM", ndërkaq në thirrjen e hapur për aplikim përcaktohen edhe kushtet për aplikim.
3. Në "UNISUM", si pjesë e dyshes mësimdhënëse vendor-ndërkombëtar, mësimdhënësi vendor mund të aplikojë nëse është pjesë e personalit akademik të UHZ –së, i cili ka një vendim dhe një kontratë valide më titull së paku Profesor asistent. Në rast se organizohen kurse ose module për gjuhë të huaja të drejtë aplikimi kanë edhe personalit me titull lektor.
4. Në raste të caktuara, në "UNISUM" mund të aplikojnë edhe personalit akademik vendor, i cili është jashtë UHZ –së të cilët po ashtu duhet të jenë njërën nga thirrjet akademie të fituara sipas Ligjit të Arsimit të lartë në Republikë e Kosovës
5. Në "UNISUM" mund të aplikojnë personalit akademik jashtë vendit, i cili duhet të ofrojë dëshmi për angzhimin shkencor dhe akademik të institucionit nga vijnë.

- Mësimdhënësi ndërkombëtar parimisht duhet të ketë edhe një bashkëmësimdhënëës vendor, për kursin që ofron. Në qoftë se nuk aplikon së bashku me një kolegë vendor për UNISUM, atëherë bashkëmësimdhënësin mund t'ia caktojë Këshilli Drejtues i UNISUM, duke respektuar fushën e kursit që ofrohet.
6. Për ofrimin e kurseve ndërkombëtare personeli akademik duhet të ketë njohuri të lartë të gjuhës angleze. Mësimdhënësit mund të inkurajohen që të ofrojnë edhe kurse në gjuhët e regjionit, në qoftë se këto kurse janë të dedikuara për studentët e familjeve që vijnë nga diaspora.
 7. Gjatë aplikimit për mbajtje të kursit në UNISUM, mësimdhënësit duhet të ofrojnë një Syllabus të shkurtuar në gjuhën angleze, duke përfshirë: Gjuhën e mësimdhënies, 5-7 pritje mësimore nga kursi, qëllimin e kursit, përmbajtjen e shkurtër, metodat e vlerësimit të studentëve, literaturën dhe kërkesat infrastrukturore të kursit.
 8. Procedura e rekrutimit dhe sipas nevojës edhe të intervistimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs zhvillohet nga Këshilli Drejtues i UNISUM me propozim të Këshillit Organizativ.
 9. Këshilli Drejtues i "UNISUM"; i propozon Senatit të UHZ-së listën me kandidatët e përshtatshëm për angazhim.
 10. Personeli akademik i angazhuar për punën në "UNISUM" do të lidhë kontratë për orë të angazhuara dhe do të kompensohet me pagë shtesë në përputhe me dispozita e ligjit për pagat dhe Rregulloret për pagesat shtesë në UHZ.
 11. Shuma e pagesës do të përcaktohet çdo vit me vendim nga Këshilli Drejtues UHZ;
 12. Mësimdhënësit e kontraktuar janë të obliguar që t'u përmbahen kushteve të kontraktuara, duke e përfshirë evidentimin e secilit aktivitet të kursit duke mbajtur rregullisht dëshmitë elektronike dhe/ose evidencat me nënshkrimet e studentëve dhe mësimdhënësit për orët dhe aktivitetet e mbajtura. Në fund të gjitha këto evidenca shoqërohen me një Raport të përbashkët të nënshkruar nga mësimdhënësit e kursit.
 13. Mësimdhënësit duhet që aktivitetet dhe diturinë e studentëve të vlerësohen vazhdimisht gjatë mbajtjes së kursit përkatës, duke përfunduar gjithmonë me Provimin final, në të cilin studentët notohen dhe me këtë i fitojnë edhe ECTS kreditë përkatëse. Raporti me listën e notave regjistrohet në sems dhe po ashtu dorëzohet me në Administratë, i nënshkruar nga mësimdhënësit përkatës.

Neni 12

Detyrat e Stafit Akademik

1. Stafi akademik i Universitetit Veror ka detyrën për të mësuar dhe këshilluar studentët e tyre në mënyrë të përshtatshme dhe efektive, duke u bazuar në parimet e drejtësisë, transparencës dhe integritetit akademik.
2. Stafi akademik ka detyrën për të zhvilluar programet e studimit, të hartojë testet dhe provimet, dhe për të vlerësuar studentët në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.
3. Stafi akademik ka përgjegjësinë për të siguruar se të gjithë studentët kanë qasje të barabartë në mundësitë e tyre për të mësuar dhe zhvilluar aftësitë e tyre.

Neni 13

Organizimi i kurseve edhe në gjuhë të huaja

Module të caktuara të UNISUM mund të përpos gjuhë shqipe ligjërohen edhe në gjuhën angleze apo boshnjake, varësisht si e përcakton këshilli drejtues i UNISUM.

Neni 14

Procedura e aplikimi të studentëve

1. Të gjithë studentët të cilët gëzojnë statusin e studentit në një institucion të Arsimit të Lartë kanë të drejtë të aplikojnë për të qenë pjesëmarrës në "UNISUM"
2. Studentët duhet të aplikojnë për modulën përkatës dhe të plotësojnë formularin standard të cilin e gjejnë në web faqen e UHZ –së.
3. Në aplikim studentit duhet të dërgojë CV-në dhe dokumentet përcjellëse.
4. Vlerësimi i kandidatëve të cilët kanë aplikuar bëhet nga Këshilli Organizativ.
5. Këshilli Drejtues bën vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatëve të cilët kanë aplikuar dhe përgatishin listën finale sipas raportit të koordinatorit të UNISUM;
6. Në "UNISUM" mund të aplikojnë studentët të cilët kanë fituar të paktën 30 ECTS kredi në studimet e rregullta.
7. Në "UNISUM" mund të aplikojnë studentët e nivelit Bachelor dhe Master.
8. Detaje tjera shtesë rreth kushteve dhe kritereve përcaktohen në thirrjen publike.

Neni 15

Të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve pjesëmarrës

1. Me përfundimin e suksesshëm të "UNISUM", studentët pajisen me certifikatën e pjesëmarrjes.
2. Studentëve duhet t'u lëshohet edhe një shtojcë e certifikatës e cila tregon përmbajtjen e modulit respektivisht kursit të përfunduar dhe numrin e ECTS kredive të fituara.
3. Studentët mund të shfrytëzojnë të gjitha burimet e UHZ-së, si: bibliotekën, sallën e IT-së dhe resurset tjera në dispozicion të studentëve.
4. Studentët janë të obliguar të respektojnë rendin shtëpiak dhe Kodin Etik të studentëve gjatë prezencës në "UNISUM"
5. Këshilli Drejtues me propozim të Koordinatorit ka të drejtë të përjashtojë nga 6. "UNISUM" pjesëmarrësit nëse shkelin rregullat e UHZ-së.

Neni 16

Aktivitetet tjera

1. Gjatë organizimit të „UNISUM“ mund të organizohen edhe aktivitete tjera.
2. Si aktivitete tjera mund të jenë:
 - a) Klube të debatit;
 - b) Tryeza të rumbullakëta;
 - c) Promovimi i librave të ndryshme;
 - d) Seminare profesionale;
 - e) Ligjërata të hapura me personalitete të njohura nga jeta publike;
 - f) Aktivitete artistike;
 - g) Master klasa në arte e muzikë;
 - h) Koncerte grupore dhe individuale

- i) Vizita nëpër vende të veçanta turistike dhe historike.
- j) Kurse të gjuhëve të huaja;
- k) Etj..

Neni 17

Tarifat e pjesëmarrjes dhe financimi i "UNISUM"

1. Me propozimin e Këshillit Drejtues të UNISUM, tarifat e pjesëmarrjes caktohen çdo vit me vendim nga Këshilli Drejtues i UHZ -së.
2. Pjesëmarrësit e "Universitetit Ndërkombëtar Veror" marrin përsipër t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet në lidhje me akomodimin, ushqimit, udhëtimit, sigurimet shëndetësore, etj.
3. Buxheti i "UNISUM" është i përcaktuar në baza vjetore me Planin Strategjik 2023 – 2026 i miratuar paraprakisht nga Këshilli Drejtues i UHZ –së;
4. Në rast se ky projekt ("UNISUM" ose të ngjashme) nuk është përcaktuar më Planin strategjik, çdo aktivitet që mund të kenë ndikim në buxhetin e UHZ –së, duhet të bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të UHZ –së;
5. "UNISUM" ka të drejtë të pranojë donacione të ndryshme nga burimet publike dhe private. Donacionet e filla duhet të bëhen transparentet dhe të shfrytëzohen për nevojat e "UHZ".
6. Të gjitha të hyrat dhe të dalat lidhur me "UNISUM" administrohen dhe realizohen vetëm nëpërmjet Shërbimit Financiar të UHZ –së dhe sipas dispozitave të ligjit për pagesat në UHZ.

Neni 18

Periudha e Organizimit të "UNISUM"

1. "UNISUM" organizohet në muajin korrik apo gusht të secilit vit kalendarik.
2. Kalendar i organizimit të "UNISUM" çdo vit propozohet nga Këshilli Organizativ dhe miratohet nga Senati i UHZ-së, në bashkëpunim me universitetet partnere ndërkombëtare dhe palët tjera të interesit.

Neni 19

Sjellja e studenteve dhe personelit akademik të angazhuar në UNISUM

1. Personelit akademik dhe Studentët në "UNISUM" priten të respektojnë rregullat dhe Rregulloret e sjelljes dhe të qeverisjes siç i ka të rregulluara UHZ – ja;
2. Studentët në "UNISUM" vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojnë;
 - a) Promovimit dhe respektimit të barazisë;
 - b) Ndalimit të çfarëdo ngacmimi dhe bullizmi;
 - c) Ruajtjes dhe kujdesit shëndetësor;
 - d) Respektimit të rregulloreve për antiplagjiaturë;
 - e) Respektimin e rregulloreve të Bibliotekës;

Neni 20

Përgjegjësitë e Studentëve

1. Studentët e Universitetit Veror kanë detyrën për të përmbushur të gjitha detyrat e tyre akademike, duke përfshirë këtu pjesëmarrjen në klasë, dorëzimin e punimeve dhe vlerësimin e tyre në mënyrë të rregullt.
2. Studentët kanë përgjegjësinë për të përmbushur të gjitha kërkesat dhe rregulloret e universitetit dhe për të ruajtur integritetin akademik në të gjitha aspektet e tyre të studimit.
3. Studentët kanë detyrën për të respektuar të drejtat dhe të interesat e të gjithë anëtarëve të universitetit dhe për të ndjekur politikën dhe procedurat e universitetit.

Neni 21

Procedura e ankesave

1. Çdo student në "UNISUM" që dëshiron të bëjë një ankesë lidhur me ndonjë përvojë e tij në kuadër të këtij projekti udhëzohet se duhet së pari të përpiqet ta zgjidhë çështjen në mënyrë joformale gjegjësisht mbi baza të mirëkuptimit dhe mirëbesimit. Në të kundërtën, studentë me ankesë duhet t'i drejtohen Kryesuesit të Këshillit Organizativ të UNISUM.
2. Kryesuesi i Këshillit organizativ, pas pranimit të ankesës, brenda afatit prej 48 orësh duhet t'i përgjigjë studentit ankues.
3. Nëse Kryesuesi i Këshillit Organizativ konstaton se ankesa e studentit është e bazuar, në varësi të ngjarjes, ka mundësi me sa vijon:
 - a) Vet në ndërmerr masa për të evituar ngjarjen pse rrethanën e caktuar;
 - b) Nëse behet fjalë për ndonjë ngjarje serioze (shkelje e lehtë ose e rëndë disiplinore) në afat prej 24 orësh duhet ta njoftojë Këshillin Organizativ dhe së bashku me këtë organ të iniciojë procedurën disiplinore e cila është e rregulluar me akte e brendshme në UHZ;
4. Në rast se Komisionet disiplinore ose të Etikës konstatojnë me vendim së studenti i caktuar në "UNISUM" është përfshirë në ndonjë shkelje të caktuar disiplinore do shqiptojnë masën e caktuar dhe për këtë do të njoftohet edhe institucioni nga vjen studenti;
5. Në raste të tilla Komisioni Disiplinor ose i Etikës do t'ia përcjellë Institucionit akademik nga vjen studenti tërë dokumentacionin e nevojshëm së bashku me provat dhe faktet;

Neni 22

Ruajtja dhe verifikimi i të dhënave

1. UHZ ka obligimin e ruajtjes të të gjitha të dhënave dhe, sipas nevojës, dokumentin e tyre në çdo kohë.
2. UHZ ka obligimin që të dhënat lidhur me ECTS, certifikatat, shtojcat e certifikatave, programet e studimit, etj, t'i ruaj fizikisht, digjitalizojë dhe arkivojë njëjtë sikurse çdo dokument zyrtarë në UHZ;
3. UHZ ka obligim, në përputhe me rregullat e brendshme të miratuara në UHZ, t'u lëshojë dublikatën ose kopjen e dokumentit palëve të interesit që kanë të drejtë për posedimin e tyre;
4. UHZ ka obligim që t'u përgjigjet zyrtarisht institucioneve vendore e ndërkombëtare partnere në rast se ato kërkojnë informata ose verifikim të

- fakteve lidhur me vijueshmërinë e studentit ose angazhimin e profesorit në "UNISUM" për periudhë e caktuar kohore;
5. Verifikimi dhe eventualisht ofrimi i të dhënave bëhet nëpërmjet zyrës për çështje akademike të UHZ –së dhe dokumenti i lëshuar nënshkruhet nga Rektori i UHZ –së;
 6. Personeli akademik dhe studentët duhet të bëjnë evidentimin e ligjëratave përmes ID- kartelave.

Neni 23

1. Senati i UHZ – së, më propozimin e Këshillit Drejtues të UNISUM mund të organizojë edhe "Universitet Ndërkombëtar Dimëror" ose ndonjë event të ngjashëm por me karakter të veçantë programor. Organizimi i punës në „Universitetin Ndërkombëtar Dimëror“ ose i ndonjë eventit të ngjashëm me karakter të veçantë programor duhet të zhvillohet përshtatshmerishtë në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.
2. Organizimi i eventit të veçantë ka mundësi të jetë edhe me i gjatë se dy javë.


Neni 24 Ndryshimet

1. Universiteti mund të bëjë ndryshime ose shtesa në këtë rregullore, kur të jetë e nevojshme, me qëllim për të përmirësuar dhe përshtatur politikat dhe procedurat e universitetit me kohën dhe nevojat e studentëve dhe stafit akademik.
2. Ndryshimet ose shtesat do të bëhen pas një procesi konsultimi me studentët dhe stafin akademik dhe do të vënë në zbatim pas miratimit të tyre nga Senati i universitetit.
3. Studentët dhe stafi akademik do të njoftohen për çdo ndryshim ose shtesë në këtë rregullore në mënyrë të qartë dhe të drejtë.
4. Ndryshimet dhe shtesat në këtë rregullore do të jenë të zbatueshme menjëherë pas miratimit të tyre nga senati dhe do të bëhen të njohura për të gjithë anëtarët e Universitetit.

Neni 25 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori i UHZ-së.
2. Ndryshimi i kësaj rregulloreje bëhet sipas procedurës së miratimit.

Kryesuesi i Senatit:


Prof. Dr. Armand Krosnjari
Rektor i UHZ –së

